

## KONTRATË

### PËR THEMELIMIN E SHOQËRISË SË THJESHTË

#### “STUDIO LIGJORE QELESHI & ASSOCIATES”

Sot, në Tiranë, më 01.10.2021 lidhet kjo Kontratë Themelimi e Shoqërisë së Thjeshtë “STUDIO LIGJORE QELESHI & ASSOCIATES “ mes palëve si më poshtë:

**ANËTAR THEMELUES 1:** **Joana Qelesi**, e bija e Arbenit, lindur në Tiranë, më 07.01.1985, e banuese në Tiranë, në adresën: Rruga “Myslym Shyri”, Pll:139, Shk:1, Ap:33, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr.personal I55107001T, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, anëtare me kontribut dhe pjesëmarrje prej 95% në shoqërinë “STUDIO LIGJORE QELESHI & ASSOCIATES”

dhe

**ANËTAR THEMELUES 2:** **Arben Qelesi**, i biri i Rafailit, lindur në Berlin, më 16.03.1960, e banues në Tiranë, në adresën: Rruga “Durrësit”, Pll:118, Shk:2, Ap:7, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr.personal G00316057C, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, anëtar me kontribut dhe pjesëmarrje prej 5% në shoqërinë “STUDIO LIGJORE QELESHI & ASSOCIATES”

(së bashku referuar si “Palët”)

**BAZA LIGJORE:** Nenet 1074 e vijues të Kodit Civil (i ndryshuar).

#### DEKLARIME PARAPRAKE

1. Palët ushtrojnë profesionin e avokatit bazuar në licencat respektive të dhëna nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe janë anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë.
2. Referuar angazhimit të njëjtë profesional dhe marrëdhënies së tyre të ngushtë familjare, Palët kanë rënë dakord për krijimin e shoqërisë së thjeshtë “STUDIO LIGJORE QELESHI & ASSOCIATES “ për ushtrimin e aktivitetit në fushën e konsulencës ligjore dhe avokatisë.

Sa më sipër, si dhe bazuar në nenet 1074 e vijues të Kodit Civil (i ndryshuar), Palët, me vullnetin e tyre të plotë, të lirë dhe të pacenuar, bien dakord të themelojmë shoqërinë e thjeshtë STUDIO LIGJORE “STUDIO LIGJORE QELESHI & ASSOCIATES “ në përputhje me kushtet e parashikuara më poshtë në këtë Kontratë



për Themelimin e Shoqërisë së Thjeshtë "STUDIO LIGJORE QELESHI & ASSOCIATES " (më tej referuar si "Kontrata").

## NENI 1

### Objekti

- 1.1. Objekti i kësaj kontrate është themelimi i shoqërisë së thjeshtë "STUDIO LIGJORE QELESHI & ASSOCIATES" (më tej referuar si "Shoqëria"), të rregullojë pozitën juridike të Shoqërisë, marrëdhëniet mes anëtarëve themelues, organeve të saj, llojin e partneritetit, kohëzgjatjen e veprimtarisë, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhënien juridiko-civile.

## NENI 2

### Veprimtaria dhe selia e Shoqërisë

- 2.1. Veprimtaria e Shoqërisë bazohet në kushte e kësaj Kontrate, si dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 2.2. Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj me seli në Tiranë, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 5.
- 2.3. Adresa elektronike e shoqërisë së thjeshtë është info@qeleshi-lawfirm.com.

## NENI 3

### Kapitali i shoqërisë

- 3.1. Kapitali i Shoqërisë është i përbërë nga kontributi i anëtarëve themelues në vlerën 1,000 (një mijë) lekë.
- 3.2. Kapitali bazë është shlyer nga anëtarët themelues në raportet e mëposhtme:
  - Nga Znj. Joana Qeleshi në masën 95 % të kapitalit bazë;
  - Nga Z. Arben Qeleshi në masën 5 % të kapitalit bazë.
- 3.3. Për regjistrimin e shoqërisë së thjeshtë kjo shumë do të depozitohet në llogarinë bankare të shoqërisë së re.

## NENI 4



### Objekti i veprimtarisë

- 4.1. Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj: "ofrimin e konsulencës ligjore dhe përfaqësimit ligjor brenda dhe jashtë vendit, në të gjitha fushat e së drejtës".

## NENI 5

### Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin për një afat të pacaktuar.
- 5.2. Veprimtaria e shoqërisë do të fillojë menjëherë pas regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon me marrëveshje të themeluesve të saj.





## NENI 6

### Shpërndarja e fitimit

- 6.1. Fitimi i realizuar do të shpërndahet midis anëtarëve themelues në përqindje proporcionale me kontributin bazë të tyre, konkretisht, Anëtari Themelues 1 do të përfitojë 95% të fitimit dhe Anëtari Themelues 2 do të përfitojë 5% të fitimit të realizuar gjatë vitit ushtrimor në bazë të pasqyrave financiare vjetore.
- 6.2. Fitimi do të shpërndahet vetëm pas likuidimit të detyrimeve që shoqëria ka ndaj të tretëve.

## NENI 7

### Detyrimet e Anëtarëve Themelues

- 7.1. Anëtarët Themelues të Shoqërisë, së bashku ose veç e veç, kanë detyrimin:
  - 7.1.1. Të regjistrojnë shoqërinë pranë të gjitha institucioneve shtetërore në përputhje me parashikimet ligjore, duke shlyer rregullisht edhe detyrimet përkatëse.
  - 7.1.2. Të derdhin kapitalin e nevojshëm për fillimin e aktivitetit të shoqërisë.
  - 7.1.3. Të sigurojnë mjediset dhe infrastrukturën e nevojshme për fillimin e aktivitetit.
  - 7.1.4. Të sigurojnë mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë së thjeshtë dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore.

## NENI 8

### Administrimi i Shoqërisë

- 8.1. Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Anëtarja Themeluese Joana Qeleshi, me afat të pacaktuar, për gjithë kohëzgjatjen e e shoqërisë.
- 8.2. Të gjitha veprimet e administrimit të Administratores Joana Qeleshi do të konsiderohen të miratuara edhe nga anëtari tjetër.

## NENI 9

### Forca madhore

- 9.1. Për qëllim të kësaj Marrëveshje, "Forcë Madhore" nënkupton një ngjarje që është përtej kontrollit të arsyeshëm të një prej palëve të kësaj Kontrate, e cila shkakton që përmbushja e detyrimeve të palës në këtë Kontratë të bëhet ose e pamundur, ose aq jopraktike sa, në mënyrë të arsyeshme, të konsiderohet e pamundur duke pasur parasysh rrethanat. Ajo përfshin, ndër të tjera, epidemitë, pandemitë, gjendjet e fatkeqësisë natyrore, luftën, mosbindjen civile, stuhi, përmbajtje ose kushte të tjera moti të vështira dhe greva.
- 9.2. Palët deklarojnë se në rastet e ekzistencës së kushteve të Forcës Madhore, kohëzgjatja e saj dhe 30 ditë mbas përfundimit të saj pezullojnë afatet e ekzekutimit të detyrimeve për palët caktuar në këtë Kontratë. Forca Madhore nuk përfshin një ngjarje, e cila shkaktohet nga neglizhenca apo veprimi me qëllim i njëres palë, as një ngjarje të cilën, një palë e kujdesshme në mënyrë të arsyeshme, duhet ta kishte marrë parasysh



në kohën e nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe që mund të ishte shmangur ose tejkaluar me përmbushjen e detyrimeve në këtë Kontratë. Forca Madhore nuk përfshin pamjaftueshmërinë e fondeve ose moskryerjen e një pagese që duhet kryer sipas Marrëveshjes.

## NENI 10

### Komunikimi ndërmjet palëve

10.1. Të gjitha komunikimet ndërmjet palëve, si dhe kërkesat që ato kanë ndaj njëra tjetrës, do të kryhen në mënyrë shkresore ose nëpërmjet e-mail-it, në selitë e Palëve cituar në hyrje të Kontratës dhe/ose në adresat e mëposhtme të e-mail-it:

10.1.1. Për Anëtarin Themelues 1: [joana.geleshi@geleshi-lawfirm.com](mailto:joana.geleshi@geleshi-lawfirm.com);

10.1.2. Për Anëtarin Themelues 2: [arben.geleshi@geleshi-lawfirm.com](mailto:arben.geleshi@geleshi-lawfirm.com).

10.2. Në rast se adresat dhe/ose e-mail-et e mësipërme pësojnë ndryshime, Pala që i pëson ato ka detyrimin të njoftojë palët e tjera brenda 24 orësh nga momenti i ndryshimit. Në rast të kundërt, çdo komunikim në adresën e mëparshme do të konsiderohet i vlefshëm edhe pse mund të mos jetë marrë nga ana e Palës që ka ndryshuar personin e kontaktit dhe/ose adresën dhe/ose e-mail-in.

10.3. Çdo komunikim ndërmjet Palëve është konfidencial dhe nuk mund t'i transmetohet në mënyrë të drejtë apo të tërthortë personave të tretë.

## NENI 11

### Interpretimi i kontratës dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

11.1. Kushtet e përcaktuara në këtë Kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e Kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, Kontrata ose kushtet e saj interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.

11.2. Për çështje, të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në Kontratë do të zbatohen nenet 1074 e vijues të Kodit Civil (i ndryshuar).

11.3. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Kontrate, Palët do të përpiqet ta zgjidhin me mirëkuptim. Në rast se Palët nuk arrijnë ta zgjidhin mosmarrëveshjen me mirëkuptim, ajo do të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe kompetente për të do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## NENI 12



## Përfundimi i Shoqërisë

12.1. Shoqëria përfundon:

12.1.1. Në rast pamundësie të realizimit të objektit të aktivitetit, ose

12.1.2. Në rast se Palët bien dakord me shkrim për përfundimin e kësaj Kontrate.

### NENI 13

#### Zgjidhja e Kontratës

13.1. Kontrata mund të përfundojë me zgjidhjen e saj në mënyrë të njëanshme nga secila prej Palëve, pa penalitet, për sa kohë Pala që kërkon zgjidhjen njofton Palën tjetër me shkrim apo nëpërmjet e-mail-it së paku 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike përpara datës në të cilën ajo mendon të zgjidhë Kontratën.

13.2. Palët kanë detyrimin që brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e zgjidhjes së Kontratës të përmbushin çdo detyrim të prapambetur kontraktor.

### NENI 14

#### Pjesë përbërëse

14.1. Bashkëlidhur kësaj Kontrate dhe pjesë përbërëse e saj janë:

14.1.1. Kopjet e letërnjoftimeve të nënshkruesve;

14.1.2. Kopje e licencave për ushtrimin e profesionit të avokatit të anëtarëve themelues;

### NENI 15


#### Dispozita të fundit

15.1. Çdo ndryshim i kësaj Kontrate bëhet me pëlqimin e përbashkët të palëve dhe do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se bëhet me shkrim.

15.2. Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) fletë, në 5 (pesë) kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

#### ANËTARËT THEMELUES:

Znj.Joana QELESHI



Z.Arben QELESHI

